URDHËR
Nr. 275, datë 15.5.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 189, DATË 1.4.2019 "PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Në shkronjën "d", të pikës 1, të urdhrit nr. 189, datë 1.4.2019, pas togfjalëshit "të ciklit të tretë", shtohet togfjalëshi "dhe/ose titujve akademikë".
2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Redi Shtino, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini